



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 1/232 Nr. i faq/Br.str/No.pg 66

Data/Datum/Date 30.05.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 253 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2009"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

**Për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor)**

- Me këtë vendim miratohet kërkesa e qytetarëve të Lagjes Krajishtë për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelat publike kadastrale sipas certifikatave të pronësisë si në vijim:
  - 1.1.Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-1 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur krajishta, me kulturë kulllosë e klasës 5, në posedim të Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5259m<sup>2</sup> (pesëmijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë metra katrorë) nga e cila ndahet sipërfaqja prej 116 m<sup>2</sup> (njëqind e gjashtëmbëdhjetë metra katror).
  - 1.2.Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-2 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur krajishta, me kulturë kulllosë e klasës 5, në posedim të Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1235m<sup>2</sup> (njëmijë e dyqind e tridhjet e pesë metra katrorë), nga e cila ndahet sipërfaqja prej 367m<sup>2</sup> (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë metra katror).
- E drejta e kalimit në pjesët e parcelave kadastrale të cekura në nenin 1 të këtij vendimi ka gjerësinë 4 (katër) metra, në jug-perëndim gjatësinë e përgjithshme prej 122.03 (njëqind e njëzet e dy pikë zero tre) metra dhe në lindje-jug gjatësinë e përgjithshme prej 121.36 (njëqind e njëzet e një pikë tridhjet e gjashtë) metra.
- Krijimi i të drejtës së kalimit në pjesët e parcelave kadastrale të cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi i dedikohet banorëve të Lagjes Krajishtë, të cilët janë posedues të pronave private e të cilët nuk kanë qasje në rrugën publike dhe si bartës të të drejtës së kalimit sipas këtij vendimi do të kenë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit, respektivisht rrugës si e mirë publike, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese të tokës komunale, me kusht që ndërtimin dhe meremetimin e kësaj rruge ta kryejnë me shpenzimet e veta.
- Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e pronës në librat kadastral.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.232/24**  
**Me datë:30.05.2024**



**Arbër Zenuni**

**Kryesues i Kuvendit**